

RAPORTI I VITIT 2015 PËR LIRITË FETARE NË BOTË - MAQEDONIA

Përmbledhje e shkurtër

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e fesë dhe shprehjen fetare. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët, pavarësisht nga besimi fetar. Pesë grupe fetare janë përmendur me emër në Kushtetutë; grupet e tjera fetare mund të regjistrohen pranë Qeverisë për përfitime të barasvlefshme me ato të pesë grupeve të përmendura. Gjykatat kanë refuzuar aplikimet e regjistrimit të katër grupeve fetare. Një gjykatë e anuloi dënimin për larje parash të kreut të Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit, e cila në të kaluarën ishte shkëputur nga Kisha Ortodokse Maqedonase - Kryepeshkopata e Ohrit (KOM-KO), dhe urdhëroi rigjykimin. Kryepeshkopi ishte liruar pak para këtij vendimi, pas tre vjet burgim me dënim për keqpërdorim të parave. Disa grupe fetare kanë njoftuar se Qeveria e ka favorizuar rKOM-KO-në si dhe ka denoncuar diskriminimin ose ngacmimin e grupeve më të vogla fetare. Kreu i grupit më të madh mysliman në vend, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni (BFI), ka deklaruar se Qeveria ka përgjuar në mënyrë të paligjshme krerët e grupit.

Një mosmarrëveshje e brendshme në kuadër të BFI-së çoi deri te okupimi 13-ditor i selisë së BFI-së nga protestuesit, pasi krerët e grupit kishin shkarkuar sekretarin e përgjithshëm dhe Myftiun e Shkupit. Okupimi përfundoi pasi që gjykata mori vendim në favor të kryesisë së BFI-së. Bashkësia Bektashiane Sufiste e Maqedonisë (në Tetovë) ka njoftuar për shqetësime nga individë të lidhur me BFI-në të cilët kanë interpretim të ndryshëm të Islamit. Disa individë kanë njoftuar për diskriminimin ose ngacmimin e burrave myslimanë me mjekra të gjata apo grave me mbulesë. Ka pasur disa akte të vandalizmit mbi varrezat dhe lokacionet fetare.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara janë takuar me përfaqësues të Qeverisë, të bashkësive fetare dhe të shoqërisë civile, për t'i diskutuar liritë fetare. Ambasadori ka diskutuar me zyrtarë të lartë të Qeverisë dhe në paraqitjet publike rreth tolerancës ndërfetare, ndërsa me kreun e BFI-së ka folur për rikthimin e pronës dhe për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ambasada ka financuar vizitën e një ligjëruesi, i cili ka diskutuar për tolerancën ndërfetare dhe përballjen me ekstremizmin e dhunshëm, si dhe ka mbështetur përpjekjet për edukimin rreth Holokaustit.

Pjesa I. Demografia fetare

Qeveria e Shteteve të Bashkuara vlerëson se popullata numëron 2.1 milionë banorë (vlerësim nga muaji korrik 2015). Nga regjistrimi i fundit shtetëror i vitit 2002 ka rezultuar se 65% e popullatës janë të krishterë ortodoksë, ndërsa 33% myslimanë. Grupet e tjera fetare, që të gjitha së bashku përbëjnë më pak se 2% të popullsisë janë katolikë, emërtime të ndryshme protestante, Dëshmitarë të Jehovait dhe hebrenj.

Pjesa më e madhe e myslimanëve janë sunitë dhe shumica e tyre jetojnë në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit, ndërsa shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në pjesën qendrore dhe juglindore të vendit. Ekziston një lidhje e ngushtë midis përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e myslimanëve janë shqiptarë etnikë. Gjithashtu, ekziston edhe një lidhje midis përkatësisë fetare dhe asaj politike pasi partitë politike, në masë të madhe, janë të ndara në linja etnike.

Pjesa II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë

Korniza ligjore

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht besimit fetar. Ajo garanton lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe në publik, në mënyrë individuale ose me të tjerët. Ajo garanton identitetin fetar të kombësive dhe komuniteteve në vend. Kushtetuta përcakton se “Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore, Komuniteti hebraik dhe komunitetet e tjera fetare” janë të ndara nga shteti dhe të barabarta para ligjit, si dhe të lira të themelojnë shkolla, organizata bamirësie dhe institucione të tjera shoqërore. Kushtetuta ndalon nxitjen e urrejtjes fetare nga partitë politike ose shoqatat e tjera.

Shteti në mënyrë specifike i njeh pesë bashkësitë fetare të përmendura në Kushtetutë. Ligji mundëson që organizata të tjera fetare të fitojnë të drejta të njëjta dhe status ligjor si të këtyre pesë grupeve duke aplikuar për njohje qeveritare dhe regjistrim përmes gjykatës. Qeveria ka miratuar këtë njohje për 30 organizata fetare (duke përfshirë 15 kisha, shtatë bashkësi fetare dhe tetë grupe fetare). Pas regjistrimit, një kishë ose grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës, për projekte të financuara nga Qeveria, si dhe për leje ndërtimi për ruajtjen kulturore të vendeve të shenjta dhe objekteve të kulturës.

Gjithashtu, mund të themelojë edhe shkollë. Mosregjistrimi nuk e pengon një grup fetar të praktikojë fenë si dhe nuk rezulton me ndonjë ndëshkim ligjor ose gjobë, por e pengon grupin që të angazhohet në aktivitete të caktuara, siç është themelimi i shkollave dhe marrja e donacioneve dhe nuk e përjashton nga pagesa e tatimit.

Organizatave fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si “kishë”, “bashkësi fetare”, ose “grup fetar.” Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Sipas autoriteteve gjyqësore, këto tri kategori trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit dhe nuk përbëjnë dallim për sa i përket të drejtave, përfitimeve ose detyrimeve ligjore. Gjykata Themelore Shkupi II i pranon aplikacionet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikacioni i organizatës fetare i përmbushë kriteret ligjore për regjistrim. Kriteret në fjalë janë: prania fizike administrative në vend; shpjegimi i besimeve dhe praktikave që e dallojnë atë prej organizatave tjera fetare; emri dhe simboli i veçantë zyrtar i grupit të ri; kategorizimi i mjeteve financiare të organizatës dhe burimeve të financimit; identifikimi i trupit mbikëqyrës që i menaxhon financat e organizatës, si dhe procesverbali i kuvendit themelues të organizatës. Ligji e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Gjykatat kërkojnë nga krerët e regjistruar të grupeve fetare të jenë shtetas.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), i cili i regjistron organizatat në Regjistrin e tij. Nëse aplikacioni refuzohet, organizata mund të parashtojë ankesë në Gjykatën e Apelit. Mjeti i vetëm të cilin mund ta shfrytëzojë organizata, në qoftë se aplikacioni refuzohet edhe nga Gjykata e Apelit, është t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në bazë të diskriminimit të të drejtave fetare. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga Gjykata Kushtetuese, organizata mund t’i ankohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Ligji nuk i lejon shkollat fillore private fetare, por e parashikon mundësinë e shkollave private fetare në nivel të shkollimit të mesëm dhe më lartë. Ministria e Arsimit i obligon nxënësit e klasës së pestë ta zgjedhin njërin prej tre lëndëve zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare: Hyrje në religjione dhe Etika në religjion. Sipas përkrahimit të Ministrisë, këto lëndë mbulojnë fenë në përgjithësi. Megjithatë lëndët zakonisht ligjërohen nga priftërinjtë apo imamë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të zgjedhin një lëndë mbi fenë, mund të zgjedhin opsionin e tretë, Kultura klasike e qytetërimit evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer aktivitete fetare ose të kryejnë rite fetare, duhet të marrin vizë pune para mbërritjes, një proces që thuhet

se zgjat rreth katër muaj. Punëtorët e huaj fetarë pastaj janë të detyruar të regjistrohen në RQGBF. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësi për zgjatje edhe për gjashtë muaj të tjerë. Rinovimet pasuese të vizave janë të vlefshme për një vit. Klerikëve dhe punëtorëve fetarë nga grupe të paregjistruara mund t’iu lëshohen viza.

Praktikat qeveritare

Sipas analistëve të ndryshëm fetarë, dallimet fetare vazhdojnë të kenë rol në rastet gjyqësore penale dhe civile. Qeveria vazhdoi të mohojë njohjen e grupeve fetare minoritare dhe ka pasur qëndrim preferencial ndaj KOM-KO.

Më 2 shkurt, autoritetet liruan me kusht kreun e Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit, Jovan Vranishkovskin, për sjellje të mirë pasi kaloi tre vjet në burg. Ai ishte dënuar për pastrim parash dhe, më herët, për përvetësim. Kryepeshkopata e Ohrit ka deklaruar se është shkëputur nga KOM-KO në vitin 2002 për t’u bashkuar me Kishën Ortodokse Serbe. Patriarku i Kishës Ortodokse Ruse ka ndërmjetësuar për lirim e Vranishkovskit gjatë një vizite të nivelit të lartë në dhjetor 2014, në bazë të KOM-KO dhe Kishës Ortodokse Ruse. KOM- KO kërkoi lirim si një gjest i vullnetit të mirë ndaj kishave ortodokse serbe dhe ruse, e cila hapi derën që KOM-KO të hap negociata me Kishën Ortodokse Serbe, për të zgjidhur statusin e KOM-KO brenda komunitetit ortodoks. Anëtarët e Kishës të Vranishkovskit deklaruan se ai ishte dënuar për bindjet e tij fetare, dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend e quajti atë të burgosur politik. Qeveria dhe KOM-KO kishin thënë se problemet e Kryepeshkopit nuk kishin të bëjnë me fenë e tij, por pasi Vranishkovski kishte deklaruar se ishte torturuar në burg në vitin 2014 për shkak të përkatësisë së tij fetare, KOM-KO në dhjetor të atij viti kërkoi të falej. Gjykata në shkurt ka liruar Vranishkovskin me kusht nga vuajtja e dënimit për përvetësim. Më 7 maj, Gjykata Supreme ka publikuar një vendim, bazuar në shqyrtimin e apelit të Vranishkovskit në shkurt, duke anuluar dënimin për pastrim të parave për shkak të parregullsive materiale dhe procedurale dhe ka dërguar çështjen për rigjykim. Në fund të vitit, rasti ishte në pritje të rigjyimit në Gjykatën Themelore Shkup 1.

Në Gjykatën Themelore Shkupi II janë dorëzuar katër kërkesa për regjistrim dhe u refuzuan në baza të ndryshme. Në janar, gjykata ka refuzuar kërkesën për regjistrimin e Kishës së Gjallë të Krishtit sepse nuk kishte bashkëngjitur listën e bazës materiale (burimet e financimit, objektin) për punën e grupit. Gjykata themelore gjithashtu ka refuzuar një kërkesë për regjistrim nga grupi Trinitas në Maqedoni, duke dhënë si arsyetim faktin se grupi nuk kishte dërguar pajtim me shkrim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për të përdorur “Maqedonia” në emërtimin e grupit dhe dëshminë se aplikuesi, Aleksandar Vuletiq, kishte

Raporti i vitit 2015 për liritë fetare në botë

Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Zyra për demokraci, të drejta të njeriut dhe punë

shtetësinë. Vuletiq nuk e ka apeluar vendimin. Gjykata themelore ka refuzuar një kërkesë të mëvonshme nga Vuletiq për regjistrimin e komunitetit të krishterë Trinitas, me arsyetimin se aplikuesi i ka paraqitur të njëjtat materiale të predikimit, si ato të Kishës së krishterë Oaza e Republikës së Maqedonisë tashmë të regjistruar. Vuletiq ka apeluar këtë vendim për Trinitas në Gjykatën e Apelit në Shkup, e cila ka konfirmuar vendimin e Gjykatës Themelore për refuzimin e kërkesës. Gjykata e Apelit mbështeti një vendim tjetër nga ana e Gjykatës Themelore për refuzimin e regjistrimit të grupit Titania.

Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit ka qenë në pritje e sipër të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me aplikacionin për regjistrim si organizatë e njohur fetare, që është refuzuar nga gjykatat mbi bazën ligjore të pamundësisë për shpjegimin e dallimit mes emrit dhe simbolit të saj, krahasuar me ato të KOM-KO. GJEDNJ e përfundoi procesin gjyqësor, megjithatë pritet ta shpallë vendimin deri në fund të vitit. Sipas KOM-KO, Kryepeshkopata ka rreth 100 anëtarë. Kryepeshkopata, e njohur nga Kisha Ortodokse Serbe, si e vetmja Kishë Ortodokse legjitime në vend, ka deklaruar se Qeveria i ka ekspozuar ndaj shqetësimeve të mediave dhe monitorimit të panevojshëm për shkak të refuzimit të tyre për të njohur pavarësinë e plotë të KOM-KO nga Kisha Ortodokse Serbe (Autoqefale). Sipas Kryepeshkopatës, numri i anëtarëve llogaritet me mijëra.

Bashkësia Bektashiane e Maqedonisë (Tetovë), një urdhër sufist islam, ka vazhduar të pres një vendim nga GJEDNJ-ja lidhur me apelin e saj të vitit 2013 me të cilin ka kërkuar nga Gjykata të hedh poshtë deklaratën e Gjykatës Kushtetuese, e cila thotë se parashtrësja e bashkësisë, në lidhje me refuzimin e regjistrimit të tyre ishte "e papranueshme për shqyrtim", sepse e mbante emrin bektashi, ndërsa një grup tjetër paraprakisht ishte regjistruar me emrin e njëjtë. Përfaqësuesit e Komuniteti Bektashi të Maqedonisë (Tetovë) thanë se BFI kishin sponsorizuar grupin tjetër bektashian dhe e kishin ndihmuar atë të regjistrohet për të bllokuar regjistrimin e komunitetit të "vetëm legjitim" bektashian në vend. Ndonëse grupi mbeti i paregjistruar, anëtarët e jashtëm të Komunitetit Bektashian të Maqedonisë (Tetovë), ishin në gjendje të marrin viza fetare.

Në nëntor Avokati i Popullit, një zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë, i ngarkuar me mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe luftën kundër diskriminimit, dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend ka thënë se përfshirja e nxënësve në ngjarje me konotacion fetar ka shërbyer për të nxitur intolerancën. Gjatë një marshi të fëmijëve në Manastir, të organizuar nga një shkollë publike, fëmijët kishin deklaruar se ata ishin aty për të "festuar vetëm festat e mira ortodokse dhe jo festat e feve të tjera." Avokati i Popullit ka deklaruar se "është e gabuar dhe e pajustificueshme të përdoren fëmijët për të promovuar një fe në Maqedoni."

Raporti i vitit 2015 për liritë fetare në botë

Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Zyra për demokraci, të drejta të njeriut dhe punë

Avokati i Popullit ka kërkuar nga Ministria e Arsimit ta hetojë marshimin e fëmijëve. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend gjithashtu e dënoi marshimin, duke deklaruar se Qeveria po acaronte marrëdhëniet ndërfaqetare.

Avokati i Popullit u ka bërë thirrje të gjitha shkollave fillore publike t'i kushtojnë vëmendje të veçantë edukimit të rinjve dhe nxitjes së tolerancës dhe respektit, në vend që të keqpërdorin lëndën mësimore Etika në religjion për të predikuar një fe specifike. Kryetarët e komunave, politikanë lokalë, dhe mediat lokale deklaruan se shumë orë mësimore nëpër shkolla i përkushtohen mësimin të një grupi të caktuar fetar, varësisht nga përkatësia fetare e mësimdhënësit.

Në shkurt lideri i BFI-së ka deklaruar se Qeveria kishte përgjuar ilegalisht krerët myslimanë, duke e quajtur këtë një "akt psikopat" dhe duke kërkuar që Qeveria publikisht të marrë përgjegjësinë ligjore për trajtimin e tij dhe bashkëpunëtorët e tij "si kriminelë." Një zëdhënës i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) i ka quajtur akuzat "qesharake."

Grupet e shoqërisë civile, duke përfshirë organizatën Nisma, një think tank i përbërë nga disa organizata joqeveritare (OJQ) ka deklaruar se Qeveria ndërhyr në çështjet fetare, në dëm të laicitetit, dhe duke politizuar fenë. Në dhjetor Kryetari i Parlamentit Trajko Veljanoski në një fjalim ka thënë se "qytetarët duhet t'u kthehen vlerave të krishtera ortodokse, nën flamurin e Krishtit."

Organizatave më të vogla fetare që nuk përmenden në Kushtetutë, si Dëshmitarët e Jehovahit, Bektashinjtë (Tetovë), dhe Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit, thanë se Qeveria nuk i trajton ato si të barabartë me pesë organizatat fetare të njohura në Kushtetutë. Si shembull, ata thanë se ishin përjashtuar nga ngjarjet zyrtare dhe nuk u është dhënë i njëjti nivel i qasjes ndaj zyrtarëve qeveritarë. Shumë grupe fetare, si BFI, Bektashinjtë (Tetovë), dhe Dëshmitarët e Jehovahit, kanë deklaruar se Qeveria ka favorizuar KOM-KO duke i dhënë privilegje unike, si për shembull duke iu dhënë në dispozicion pronë publike, pa pagesë, duke ofruar fonde për ndërtimin e kishave të reja ortodokse, si dhe duke siguruar ftesa ekskluzive për përfaqësuesit e saj për të marrë pjesë në ngjarje qeveritare. KOM-KO ka mohuar çdo lidhje me Qeverinë dhe ka thënë se Kisha nuk përfshihet në politikë.

Në mars zyrtarët e pushtetit lokal morën pjesë në ceremoninë e përvitshme për ngritjen e një kryqi ortodoks me lartësi prej 12 metra në komunën e Shkupit Gjorçe Petrov, dhe në tetor përfaqësues të Qeverisë morën pjesë në ceremoninë e përvitshme të një kisha KOM-KO në Prilep. Mediat lokale njoftuan se Qeveria ka ndihmuar financimin e ndërtimit të kryqit dhe të kishës dhe gjithashtu kishte lehtësuar padrejtësisht procesin e marrjes së lejes. Në shkurt pushteti qendror dhe

Qyteti i Shkupit kanë ndarë 87 milionë denarë (1,5 milion dollarë) për të rinovuar Kryqin e mijëvjeçarit të lartë 66 metra, që i përket një grupi gjithëkrishterë në majën e malit Vodno, mbi Shkupin.

Pjesa III Gjendja e respektimit shoqëror të lirive fetare

Në maj BFI shkarkoi sekretarin e përgjithshëm dhe Myftiun e Shkupit. Një ditë më vonë, një grup i armatosur nga pasuesit e udhëheqësve të shkarkuar u fut me forcë në ambientet e selisë të BFI-së në Shkup. Incizimet nga kamerat e sigurisë treguan dhjetëra njerëz duke kapërcyer gardhin, duke thyer një derë qelqi, dhe duke shtyrë njerëzit mënjanë ndërsa u futën me nxitim brenda godinës. Sipas mediave dhe grupeve të shoqërisë civile, sulmi ishte një përpjekje për të marrë kontrollin mbi udhëheqësinë e grupit; BFI ka deklaruar se Qeveria ka inkurajuar sulmuesit për të destabilizuar BFI-në. Ministria e Brendshme ka vendosur efektivë të policisë për të ndarë të dy palët, por nuk i ka dëbuar ndërhyrësit. Okupimi 13-ditorë i selisë të BFI-së ka përfunduar vetëm pas një vendimi të gjykatës për të njohur kryesinë e BFI-së si përfaqësuese legjitime e organizatës.

Bektashinjtë kanë njoftuar për incidente të shqetësimit nga pjesëtarët e BFI-së, të cilët e kanë okupuar kompleksin Harabati Baba Teqe në Tetovë. Përfaqësuesit bektashianë kanë raportuar se në vazhdimësi ishin shqetësuar verbalisht, duke thënë se njerëzit u kishin thënë të largohen nga kompleksi.

Disa individë kanë njoftuar për paragjykime shoqërore kundër burrave myslimanë me mjekra të gjata dhe grave me mbulesë. Në një rast një mjek mysliman nga Gostivari ka deklaruar se i është nënshtruar ngacmimeve të policisë kufitare dhe kontrollit të panevojshëm, me çka janë vonuar kalimet e tij kufitare sa herë ka hyrë dhe ka dalë nga vendi.

Mediat pro-qeveritare, si gazeta Veçer dhe televizioni Sitel, kanë portretizuar negativisht kreun e Kishës së Gjallë të Krishtit si një "ekzorcist" dhe një "sektar", pasi që ishte refuzuar aplikimi i tij për regjistrimin e grupit.

Më 6 nëntor, pas një proteste anti-Islam në Kriva Pallankë, sulmuesit kanë dëmtuar një xhami të improvizuar të përdorur kryesisht nga besimtarët romë. Mediat lokale kanë njoftuar se në protesta kanë marrë pjesë 1200 qytetarë, ku kanë shprehur zemërimin e tyre pas njoftimit se xhamia do të ndërtohej në qytet. Protesta u organizua nën moton "Jo islamizimit të Kriva Pallankës", dhe thuhet se është mbështetur nga kryetari i komunës së Kriva Pallankës. Komiteti i Helsinkit në vend e quajti protestën një "akt i gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës fetare," ndërsa Valentina Bozhinovska, kryetare e KMBFGR, organ qeveritar që kujdeset për dialogun midis grupeve fetare, tha se incidenti ishte "i papranueshëm". Disa parti

Raporti i vitit 2015 për liritë fetare në botë

Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Zyra për demokraci, të drejta të njeriut dhe punë

politike kanë lëshuar deklarata duke bërë thirrje për paqe dhe tolerancë. Policia ka zhvilluar hetime mbi vandalizmin dhe deri në fund të vitit ka marrë në pyetje rreth 40 persona, por nuk ka bërë ndonjë arrestim. Qeveria nuk ka ndjekur penalisht askënd për gjuhën e urrejtjes, si rezultat i protestës, pavarësisht ankesave nga grupet e shoqërisë civile për ta bërë këtë.

Aktet e vandalizmit në varreza dhe objektet fetare kanë vazhduar. Në shtator vandalë të panjohur kanë përdhosur varrezat myslimane në Ohër. Në mars persona të panjohur i kanë spërkatur me bojë muret e kishës ortodokse në Tetovë dhe xhamisë në Manastir me mbishkrime të turpshme.

KOM-KO ka njoftuar për 25 plaçkitje në kishat dhe manastiret ortodokse në të gjithë vendin. Pre e plaçkitjeve kanë qenë kryesisht paratë e mbledhura nga donacionet dhe një numër i vogël i objekteve të trashëgimisë kulturore si p.sh. ikona.

Fondi i Holokaustit i hebrenjve nga Maqedonia, një OJQ, ka vazhduar të punojë me Ministrinë e Arsimit për të zbatuar programe mësimore të historisë hebreje dhe për të promovuar bashkëpunimin ndërfaqësor.

Pjesa IV Politika qeveritare e Shteteve të Bashkuara

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara, u takua me zyrtarë të BFI-së për të diskutuar çështje siç është kthimi i pronave dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, përfaqësuesi i Ambasadës u takua me përfaqësues të grupeve të vogla fetare, Qeverisë dhe shoqërisë civile për të diskutuar lidhur me lirinë fetare.

Ambasadori organizoi një iftar ku ishin ftuar zyrtarë qeveritarë, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme fetare, me ç'rast ai foli për rëndësinë e tolerancës fetare dhe i inkurajoi të pranishmit të nxisin tolerancën në komunitetet e tyre. Përveç kësaj, zyrtarë të Ambasadës kanë diskutuar për rëndësinë e tolerancës ndërfaqësore gjatë pranisë së tyre në iftare të ndryshme në komunitet. Ambasadori foli për lirinë dhe tolerancën fetare në një ngjarje përkujtimore të Holokaustit në tetor.

Në mars Ambasada ka financuar vizitën e një kleriku mysliman nga një universitet jezuit në Shtetet e Bashkuara, i cili foli në disa qytete për rëndësinë e tolerancës ndërfaqësore, dhe tema të tjera lidhur me lirinë fetare në universitet, të rinjtë dhe grupet fetare.

Ambasada ka mbështetur Fondin e Holokaustit të hebrenjve të Maqedonisë me dy grante të vogla, një për të mbuluar shpenzimet për mësimdhënësit që vijnë nga

jashtë kryeqyteti për të marrë pjesë në një seminar arsimor për Holokaustin në Shkup, dhe një tjetër për të financuar udhëtimin e një pjesëmarrësi.